


STATUT
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA

“SILLOSI” Sh.p.k.

Korrik 2022

A handwritten signature in black ink, consisting of several stylized, overlapping strokes.

Në Tiranë, sot me datë 26 Korrik 2022, me zbatim të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si edhe të Ligjit nr.131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", vendoset të themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar M&SILLOSI ALBANIA Sh.p.k., nga Ortaku i vetëm:

1. **Z. Artan Devolli**, shtetas kosovar, i lindur me 03.05.1982, në Pejë, me nr. personal në letërnjoftim 1001424862 dhe me numër të pasaportës P02097219, banues në adresën Rr. Shefqet Shkupi, Pr Stars, B/A, Nr. 60, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Neni 1 EMËRTIMI I SHOQËRISË

- 1.1. "SILLOSI" Sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 1.2. Aktiviteti i kësaj shoqërie rregullohet nga ky statut dhe nga Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
- 1.3. Emërtimi i shoqërisë tregtare është "**SILLOSI**" Sh.p.k.
- 1.4. Shoqëria fiton personalitet juridik në momentin e regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 2 ORTAKËT E SHOQËRISË

- 2.1. Shoqëria është themeluar nga një ortak i vetëm, **Z. Artan Devolli**.
- 2.2. Z. Artan Devolli, si ortak i vetëm, përgjigjet për humbjet e shoqërisë deri në vlerën e kapitalit themeltar të saj.

Neni 3 SELIA E SHOQËRISË

- 3.1. Selia e Shoqërisë ndodhet në Njësia Bashkiake, Nr. 6, Rruga "Feridon Fezollari", Ndërtesa THG, Tiranë, kodi postar 1028.
- 3.2. Shoqëria mund të hap zyra përfaqësimi, degë ose filiale dhe ose të marrë pjesë në shoqëri të tjera, të kryejë aktivitetet në vende të tjera, brenda apo jashtë territorit të Shqipërisë.

Neni 4 KOHËZGJATJA

- 4.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 5 OBJEKTI I AKTIVITETIT



5.1. Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**SILLOSI**” Sh.p.k., do të jetë:

- Përpunimi i produkteve të drithërave
- Përpunimi i niseshtesë dhe i produkteve të niseshtesë
- Prodhimi i biskotave dhe galetave; prodhimi i pastave dhe kekëve të konservuar
- Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët e fermës
- Prodhimi i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta
- Prodhimi i kakaos, çokollatës dhe ëmbëlsirave
- Tregtia me shumicë e drithërave, duhanit të papërpunuar, farërave dhe ushqimit të kafshëve
- Tregtia me shumicë, jo e specializuar, e artikujve ushqimorë, pijeve dhe duhanit
- Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e mallrave ushqimore, pijeve dhe duhanit
- Përpunimi i ushqimeve të përgatitura për kafshët shtëpiake
- Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor
- Transporti rrugor i mallrave
- Prodhimi i makaronave, shpagetave dhe produkteve të ngjashme nga mielli
- Përpunimi i ushqimeve të homogjenizuara dhe ushqimeve dietike
- Tregtia me shumicë e produkteve kimike
- Testimi teknik dhe analizat
- Shpërndarja e energjisë elektrike
- Tregtia e automjeteve të tjera
- Tregtia e veturave dhe automjeteve me fuqi motorike të vogël
- Aktivitetet e tjera mbështetëse të transportit
- Prodhimi i sheqerit
- Riparimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të tjera të transportit të p.k.t.
- Prodhimi i energjisë elektrike
- Transmetimi i energjisë elektrike
- Tregtia me shumicë e sheqerit, e çokollatës dhe e ëmbëlsirave
- Tregtia me pakicë e luleve, bimëve, farërave, plehrave artificialë, kafshëve përkëdhelëse dhe ushqimi i tyre, në dyqane të specializuara
- Përpunimi i vajrave dhe yndyrave
- Instalimi i makinerive dhe pajisjeve industriale
- Tregtia me pakicë e produkteve të tjera ushqimore në dyqane të specializuara
- Aktivitetet ndihmëse për prodhimet bimore
- Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve
- Veprimtaritë e paketimit (ambalazhimit)

Neni 6 KAPITALI THEMELTAR

6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000.00 Lekë (njëqind mijë lekë).

6.2. Kapitali themeltar është i ndare ne 1 (një) kuotë.

6.3. Vlera nominale e një kuote është 100,000.00 Lekë (njëqind mijë lekë).

6.4. Ortaku i vetëm është zotëruesi i të gjitha kuotave të shoqërisë, në vlerën 100% të tyre.

6.5. Çdo kuotë përfaqëson të drejtën e një vote.

Neni 7 KUOTAT DHE TRANSFERIMI

- 7.1. Kuotat janë të transferueshme dhe mund të transferohen në çdo kohë, në përputhje me kushtet dhe afatet që përcaktohen nga ligji në fuqi.
- 7.2. Përgjegjësia e ortakut është deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e shoqërisë.
- 7.3. Krahas ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë, si edhe të mundësive ekonomiko-financiare që do të krijohen, kontributet e saj mund të jenë edhe në natyrë (pasuri të paluajtshme apo të luajtshme) siç mund të vendoset nga Ortaku i vetëm.
- 7.4. Kapitali i shoqërisë do të rritet ose do të zvogëlohet në përputhje me ecurinë e veprimtarisë së saj ekonomiko-financiare dhe tregtare, si dhe të vendimeve që do të ndërmarrë në të ardhmen Ortaku i vetëm.

Neni 8 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

- 8.1. Në përputhje me kushtet dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë, si edhe të vendimeve që do të merren nga Ortaku i vetëm, shoqëria mund ta zmadhojë ose ta zvogëlojë kapitalin në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
- 8.2. Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Organet DREJTUESE DHE TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË

Neni 9 ORGANET E SHOQËRISË

9.1. Organet drejtuese të shoqërisë "SILLOSI" Sh.p.k., janë:

- **Ortaku i vetëm**
- **Administratori**

Neni 10 ORTAKU I VETËM, KOMPETENCAT

10.1. Ortaku i vetëm ka këto kompetenca:

- a. ndryshimet në dispozitat e statutit;
- b. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- c. emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
- d. emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d të kësaj pike;
- f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

- g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j. përfaqësimin e shoqërisë;
 - k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të shoqërisë;
 - m. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 10.2. Ortaku i vetëm veç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni ka të gjitha të drejtat dhe kompetencat në lidhje me administrimin e shoqërisë, me përjashtim të atyre që ky statut ia njuh dhe ngarkon Administratorit.

Neni 11 ADMINISTRATORI


- 11.1. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të vetëm.
- 11.2. Në aktin e emërimit përcaktohet edhe periudha e qëndrimit në detyrë. Në rast se kjo periudhë nuk është e përcaktuar në aktin e emërimit ajo në çdo rast nuk mundet të jetë më shumë se 5 (pesë) vite, duke filluar nga data e emërimit.
- 11.3. Administratori i parë i shoqërisë është Z. **Arber Salihu**, i lindur me 06.04.1992, me adresë banimi Rr. Muhamet Gjollësja, Pallati Bardhë e Kaltër, Kati 2, Apartamenti 4, Tiranë, i cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

Neni 12 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

- 12.1. Administratori i shoqërisë ka këto kompetenca:
- a. përfaqëson interesat e shoqërisë në raport me palë të treta;
 - b. kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - c. të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - d. kryej regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - e. përgjigjet për administrimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
 - f. nënshkruan marrëveshje në emër dhe për llogari të shoqërisë sipas përcaktimeve në këtë statut;
 - g. përgatitë raportin vjetor të administrimit të shoqërisë, inventarët dhe llogaritë vjetore;
 - h. emëron dhe shkarkon personelin e shoqërisë;
 - i. të tjera të parashikuara me këtë statut.

Neni 13 TË DREJTAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT

- 13.1. Administratori është i detyruar të respektojë këtë statut si dhe çdo akt tjetër të Ortakut të vetëm që lidhet me veprimtarinë dhe aktivitetin e shoqërisë.



- 13.2. Administratori është i detyruar të paraqesë raporte dhe informacione mbi ecurinë e aktivitetit të shoqërisë, minimumi çdo 3 (tre) muaj dhe në çdo rast me kërkesën e Ortakut të vetëm.
- 13.3. Administratorit i ndalohej shitja dhe blerja e pasurive të paluajtshme në emër dhe për llogari të shoqërisë, nëse nuk ka një autorizim me shkrim nga Ortaku i vetëm.
- 13.4. Administratori është i detyruar të vërë në dijeni Ortakun e vetëm për çdo marrëveshje të nënshkruar në emër dhe për llogari të shoqërisë, jo më vonë se dy ditë nga nënshkrimi i saj.
- 13.5. Administratori është i detyruar që të ruajë dhe të respektojë çdo të dhënë që lidhet me aktivitetin ekonomik dhe financiar të shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur ato kërkohen nga organet kompetente për qëllim të zbatimit të ligjit. Gjithashtu Administratorit i ndalohej që të përdorë për qëllime të tjera apo të palëve të treta, njohuri ose informacione të cilat ai i ka mësuar për shkak të pozitës së tij si Administrator i shoqërisë.

Neni 14 PERSONELI I SHOQËRISË

- 14.1. Personeli i shoqërisë emërohet dhe shkarkohet me vendim të Administratorit në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Punës, Statutin e shoqërisë si dhe akte të tjera të Ortakut të vetëm.
- 14.2. Numri i punonjësve, struktura, si dhe niveli i pagave përcaktohen me vendim të Ortakut të vetëm mbi bazë të propozimit të Administratorit.
- 14.3. Administratori duhet të informojë Ortakun e vetëm jo më pak se një herë në tre muaj mbi numrin e të punësuarve në shoqëri.

MBLEDHJET DHE VENDIMARRJA NË SHOQËRI

Neni 15 AKTET E ORTAKUT TË VETËM

- 15.1. Ortaku i vetëm administron shoqërinë nëpërmjet akteve të ndryshme të miratuara prej tij.
- 15.2. Aktet duhet të jenë me shkrim si dhe të regjistrohen në një regjistër të posaçëm.

KREU V VITI USHTRIMOR

Neni 16

- 16.1. Llogaritja e shpenzimeve, të ardhurave dhe fitimit për shoqërinë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik.
- 16.2. Përjashtimisht viti i parë ushtrimor fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

SHPËRNDARJA DHE PRISHJA

Neni 17

- 17.1. Shoqëria mund të shpërndahet me vendim të Ortakut të vetëm. Shpërndarja e shoqërisë do të ndiqet nga prishja e saj.
- 17.2. Vendimi për prishjen e shoqërisë duhet të jetë me shkrim dhe duhet të depozitohet në Regjistrin Tregtar.
- 17.3. Shoqëria do të ruajë personalitetin juridik për qëllime që lidhen me likuidimin dhe emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët "në proces likuidimi".
- 17.4. Procesi i prishjes së shoqërisë dhe emërimi i likuidatorëve do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 17.3. Shkaqet e prishjes së shoqërisë:
- me vendim të Ortakut të vetëm;
 - me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - me bashkimin me ndonjë shoqëri tjetër apo me ndarje;
 - nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
 - me vendim të gjykatës.

Neni 18

LIGJI I ZBATUESHËM

- 18.1. Shoqëria do të kryejë dhe zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe me dispozitat ligjore në fuqi të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.
- 18.2. Aplikimi i Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" do të jetë në përputhje dhe për sa nuk është parashikuar ndryshe në këtë statut.
- 18.3. Në rast se nuk është parashikuar ndryshe në këtë Statut, i aplikueshëm do të jetë ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Neni 19

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 19.1. Kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeve që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë është Gjykata Kompetente në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20

NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E STAUTIT

- 20.1. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti mund të bëhen vetëm me vendim të themeluesit.
- 20.2. Ndryshimet janë të vlefshme vetëm në rast se ato pasqyrohen në Regjistrin Tregtar.

Neni 21

HYRJA NË FUQI

21.1. Ky statut është i hartuar në katër ekzemplarë në gjuhën shqipe dhe hynë në fuqi me miratimin dhe pranimin e depozitimit të tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

ORTAKU I VETËM

Artan Devolli

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'AD', written over a faint, larger version of the same signature.